

VENDIM
Nr.32, datë 18.7. 2005

PËR ZBATIMIN E RREGULLAVE TË MIRATUARA NGA ERE PËR FATURIMIN E ENERGIJË ELEKTRIKE DHE KRYERJEN E SHËRBIMEVE NDAJ KONSUMATORIT

Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e datës 18.7.2005 mbi bazën e programit të miratuar nga kryetari i ERE-s në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të disa ankesave të bëra nga konsumatorët për sasinë dhe mënyrën e faturimit të energjisë elektrike, mori në shqyrtim relacionin dhe aktin e kontrollit të ushtruar nga Departamenti i licencave dhe Monitorimit dhe Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave në KESH sh.a. (Zona e shpërndarjes elektrike, Tiranë), dhe pas diskutimit të anëtarëve të tij për pjesën e kontrolluar të kësaj zone, arriti në këto konkluzione:

Në zonën e Tiranës nuk janë instaluar matës tek 30 888 abonentë ose 16 % në 192 426 abonentë gjithsej. Është e ndjeshme mungesa e matësve për konsumatorët familjarë, por janë akoma edhe 2326 abonentë privatë (biznese) të pakompletuar me matës. Në raportimet e mëparshme të KESH sh.a., sipas sistemit të informacionit periodik të miratuar nga ERE, në fund të muajit mars 2005 rezultojnë 13 620 abonentë pa matës ose 56 % më pak nga sa ka zbuluar kontrolli i ERE-s. Në 18.536 abonentë familjarë objekti i kontrollit nga ERE, rezulton se për 74 % të tyre është zbatuar sasia mujore e faturimit aforfe e vendosur nga ERE ndërsa për 3441 abonentë faturimi është bërë për sasinë 800 kWh në muaj dhe për 1315 abonentë faturimi është bërë për sasinë 1200 kWh në muaj nga 600 kWh në muaj që ka qenë përcaktuar sipas vendimit të ERE-s nr.48, datë 21.10.2004 KESH sh.a. (Zona e shpërndarjes elektrike Tiranë) nuk ka zbatuar në asnjë rast vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.15, datë 11.3.2005 “Për kompensimin e konsumatorëve ndaj të cilëve nuk janë zbatuar vendimet e ERE-s për vlerat e faturimit aforfe”. Faturimi aforfe është bërë në mënyrë arbitrare dhe mbi baza subjektive nga personeli përkatës. Cilësia e shërbimit ndaj konsumatorëve, në lidhje me transparencën për leximin e matësit, dërgimin e faturës dhe dhënien e një përgjigjeje të shpejtë për ankesat e konsumatorëve, nuk është vlerësuar si duhet nga personeli i ngarkuar.

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa b, ç dhe g, 9, 26 pika 1, 52 dhe 64 germa c të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. KESH sh.a., për 3441 abonentë, të cilëve u ka bërë faturim mujor aforfe 800 kWh, nga 600 kWh në muaj të miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s të bëjë menjëherë kompensimin e plotë të sasisë së energjisë elektrike të faturuar më tepër.

2. KESH sh.a., për 1315 abonentë, të cilëve u ka bërë faturim mujor aforfe 1200 kWh, nga 600 kWh në muaj të miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s të bëjë menjëherë kompensimin e plotë të sasisë së energjisë elektrike të faturuar më tepër.

3. KESH sh.a. të dënohet me gjobë në shumën 300 000 (treqindmijë) lekë.

4. Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema